



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo  
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik  
Regulatorna Komisija Javne Nabavke  
Public Procurement Regulatory Commission



Nr. 81 / 2020  
18.12.2020

Në bazë të nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në paragrafin 2 të nenit 7 të Rregullores së Punës, Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik nxjerrë këtë:

## NJOFTIM

### Për të gjitha Autoritetet Kontraktuese dhe Operatorët Ekonomik

**NJOFTOHEN** të gjitha Autoritetet Kontraktuese se nga data 14.01.2021 obligohen t'i përdorin **Format Standarde të parashtrimit të kërkesave**, kurdo që janë të interesuara të marrin Këshilla/interpretime nga Departamenti i Rregullave në KRPP përmes postës elektronike zyrtare të Departamentit të Rregullave: [rregullat.krpp@rks-gov.net](mailto:rregullat.krpp@rks-gov.net).

Kërkesa për Këshilla/Interpretime duhet të përmbajë emrin (Logon) e Institucionit, emrin e parashtruesit, e nënshkruar edhe nga ZKA apo titullari i Institucionit, protokollohet dhe dërgohet përmes postës elektronike apo në formë fizike.

Gjithashtu,

**NJOFTOHEN** të gjithë Operatorët Ekonomik se nga data 14.01.2021, Kërkesat për Këshilla/Interpretime duhet të përmbajnë emrin e (logon) e Kompanisë, emrin e parashtruesit, datën dhe nënshkrimin e pronarit (drejtorit, menaxherit) të kompanisë, protokollohet dhe dërgohet përmes postës elektronike apo në formë fizike.

Kërkesa e parashtruar në postën elektronike zyrtare apo në kopje fizike, duhet të jetë mjaftueshëm e qartë, për t'i mundësuar ekspertit të prokurimit identifikimin e pretendimeve dhe qëllimin e saj.

Asnjë kërkesë **NUK** do të trajtohet nëse nuk është në formën siç është ceke me lartë.

Osman VISHAJ

Kryetar i Komisionit rregullativ për Prokurimin Publik

